



MEMORANDUM PËR BASHKËPUNIM

Ndërmjet

BASHKIMI I SINDIKATAVE TË PAVARURA TË KOSOVËS (BSPK)

Dhe

SHOQATA KOSOVARE PËR MBROJTJE DHE SHËNDET NË PUNË (KOSHA)

Shoqata Kosovare për Mbrojtje dhe Shëndet në Punë (KOSHA) dhe Bashkimi I Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK), vendosën të avancojnë bashkëpunimin me nënshkrimin e këtij memorandumi për bashkëpunim.

Qëllimi i këtijë memorandum është shprehja e përkushtimit për bashkëpunim dhe mbështetje në realizimin e qëllimeve të dy organizatave në sigurinë dhe shëndetin e popullatës punuese në Kosovë.

Shoqata Kosovare për mbrojtje dhe shëndet në punë (KOSHA) dhe Bashkimi I Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK), do të punojnë në ngritjen e sigurisë dhe shëndetit në punë në nivel më të lartë duke punuar në projekte të përbashkëta të cilat do të ndërthurin dhe në të njëjtën kohë nuk do të limitojnë në:

- Njoftimin e legjislacionit Nacional në lidhje me mbrojtjen dhe shëndetin në punë;
- Njoftimin e standardeve Europiane në lidhje me mbrojtje dhe shëndet në punë në Kosovë;
- Aktivitete të përbashkëta në edukimin dhe trajnimin ekspertëve për mbrojtje në punë dhe popullatës punuese;
- Këmbimin e informatave, diturive dhe përvojës të cilat do të ishin në interes për të dy organizatat;
- Krijimin dhe implementimin e projekteve me interes për të dy organizatat dhe prezentimi para donatorëve të mundshëm.

Sipas nevojës, para implementimit të aktiviteteve të përbashkëta, e posaqërisht nëse kemi të bëjmë me implikimin e buxhetit mes organizatave nënshkruese të këtij Memorandumi, marrëveshje shtesë do të nënshkruhen për rregullimin e obligimeve mes këtyre organizatave.

Memorandumi për Bashkëpunim është valid pas nënshkrimit nga ana e përfaqësuesve nga të dy organizatat.

Haxhi Arifi

Fatmir Saraçini

Kryetar I BSPK

Udhëheqës I KOSHA